



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 549/ 6 prot.

Datë 15/04/2025

V E N D I M

Nr. 507/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15/04/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “CHIMICA-AL” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-29714-11-15-2024 me objekt: “Blerje Kimikate për UKT sh.a e ndarë në lote”, me fond limit të përgjithshëm 198.275.000 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) leke pa tvsh ose 2.019.505 (dy milion e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesë) euro pa tvsh, Loti 1, me numër reference: REF-29716-11-15-2024, me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%”, me fond limit të lotit 75.250.000 (shtatëdhjetë e pesë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh ose 735.893,3 (shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre presje tre) euro pa tvsh, zhvilluar me datë 09.01.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SH.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “CHIMICA-AL” SHPK me NIPT M31703048H, dhe me adresë: Njësia administrative Vaqarr Fshati Lalm ,Ndërtesë private (magazinë).Nr.3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SH.A
Adresa: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027,Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.11.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-29714-11-15-2024 me objekt: “Blerje Kimikate për UKT sh.a e ndarë në lote”, me fond limit të përgjithshëm 198.275.000 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) leke pa tvsh ose 2.019.505 (dy milion e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesë) euro pa tvsh, Loti 1, me numër reference: REF-29716-11-15-2024, me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%”, me fond limit të lotit 75.250.000 (shtatëdhjetë e pesë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë

pa tvsh ose 735.893,3 (shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre presje tre) euro pa tvsh, zhvilluar me datë 20.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë SH.A.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 25.11.2024, në mbështetje të nenit 75 pika 2 të ligjit nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe bazuar në kërkesën për sqarim të operatorit ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” ShPK ka modifikuar kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.9 dhe pikën 2.10 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” Loti 1 “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%”, si më poshtë vijon:

“Të nderuar operatorë ekonomikë!

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të ligjit nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” bazuar në kërkesën për sqarim të një operatori ekonomik të interesuar, AK ju bën me dije se ka bërë modifikimin e kriterit kualifikues si më poshtë vijon :

Ne kriteret e veçanta të kualifikimit përkatesisht në pikën 2.9 është kërkuar si më poshtë cituar

2.9.Një punësim mesatar i të paktën 2(dy) personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;*

(Nëse operatori ekonomik oferton për lote të veçanta, nr.i punonjësve duhet të korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumës së loteve që oferton)

2.10.Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjete (brenda numrit të kërkuar në pikën 2.9).

- Për punonjës të kimistit operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, dhe kontratë pune (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar)

- Për punonjës të drejtuesit mjete dokumentat që duhet të paraqesin janë: Leje drejtimi për mjete që kryejnë transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e muajit të fundit të shoqërisë.

- Për rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpërmjet kontratës së qerasë atëherë operatori ekonomik për punonjës të drejtuesit mjete duhet të paraqesë kontratë punësimi për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.*

-

Shënim: Për pikat 2.9, 2.10 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Behet:

2.9.Një punësim mesatar i të paktën 2(dy) personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;

(Nëse operatori ekonomik oferton per lote te vecanta, nr.i punonjësve duhet ti korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumes se loteve qe oferton)

2.10.Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjeti.

- Për punonjësin “Kimist” operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, dhe kontratë pune (e vlefshme per të paktën periudhën e parashikuar)

- Për punonjësin “Drejtues mjeti” dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe te figurojë në listpagesat e muajit të fundit të shoqerisë.

- Për rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpermjet kontratës së qerasë atëherë operatori ekonomik për punonjësin “Drejtues mjeti” duhet të paraqesë **kontratë punësimi** për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

Shënim: Për pikat 2.9, 2.10 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.“.

II.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 17.12.2024, në mbështetje të nenit 75 pika 2 të ligjit nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe bazuar në monitorimin e Agjencisë së Prokurimit Publik datë 16.12.2024, ka modifikuar kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pikën 2.3.1 “Aftësitë teknike dhe profesionale” dhe pikën 2.8 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” Loti 1 “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%”, si më poshtë vijon:

“Të nderuar operatorë ekonomikë!

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të ligjit nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” bazuar monitorimin e App date 16.12.2024 AK ju bën me dije se ka bërë modifikimin dhe Sqarimin e kriterëve kualifikues si më poshtë vijon :

Ishte:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

*2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Nëse operatori ekonomik oferton për lote të veçanta, vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës të kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit përkatës , ose shumës se loteve që oferton).

Bëhet:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/a e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.*

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Ishte:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël 30.100.000 (tridhjetë milion e njëqind mijë) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara,

ose,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara.

Bëhet:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se **40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat **dhe sasi të mallrave të furnizuara**.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat **dhe sasi të mallrave të furnizuara**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin

dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Ishte:

2.8. Në rast se operatori ekonomik është importues atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL për të gjitha kimikatat e kërkuara nga AK.

Në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas atëherë operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratë furnizimi me një prodhues vendas shoqëruar me lejen mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL të prodhuesit vendas ose kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Bëhet:

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës nëse është prodhues duhet të paraqesë **Leje Mjedisore të tipit A**, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Nëse operatori ekonomik ofertues nuk është vetë prodhues i produkteve objekt prokurimi të Lotit , duhet të ketë **Kontratë/a furnizimi me prodhues të cilët janë** të pajisur me lejet mjedisore.

Për përmbushjen e këtij kriteri të paraqiten kontrata/t e furnizimit të vlefshme si edhe lejet mjedisore përkatëse sipas përcaktimit të bërë në kriterin 2.8 të DT.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77 të LPP si dhe konform përcaktimeve të bëra në ligjin nr 10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar. Kërkesa për qënësini e kësaj leje mjedisore kërkohet vetëm dhe vetëm për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se veprimtaria për prodhimin e kimikateve bëhet në përputhje me rregullat mjedisore si dhe duke patur një qasje pozitive edhe miqësore kundrejt natyrës dhe mjedisit në tërësi.

Në stabilimentet e prodhimit të kimikateve kryhen procese pune të cilat shkaktojnë dhe gjenerojnë mbetje të cilat mund të shkaktojnë ndotje në ujë dhe tokë, duke krijuar ndikim për biodiversitetin dhe shëndetin e popullsisë.

Pajisja me leje mjedisore siguron që veprimtaritë e përcaktuara të jenë në përputhje me masat e mbrojtjes së mjedisit.Parandalimi i ndotjeve dhe mbetjeve të rrezikshme siguron një mjedis më të sigurt për popullsinë. Së fundmi LPP dhe RRPP me ndryshimet që kanë pësuar kanë sjellë në vëmendje dispozita të cilat lidhen dhe të orientojnë drejt prokurimit të gjelbër. Theksojmë se VKM nr 498 datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, sipas të cilit u ndryshua edhe neni 25 “Kriteret e Kualifikimit” parashikon se Autoritetet Kontraktore janë të detyruara që në hartimin e kriterëve të veçanta dhe specifikimeve të

zbatojnë legjislacionin mjedisor, social e të punës – në mënyrë që të të ulet ndikimi negativ në mjedis. Pra përfshirja e kriterëve të gjelbra impakton në atë që promovohet gjithnjë e më shumë dhe që quhet “Prokurimi i qëndrueshëm”, pra një proces ku Autoritetet Kontraktore përmbushin nevojat e tyre për mallra, shërbime ose pune në një mënyrë duke impaktuar në minimizimin e dëmtimit të mjedisit.

Ne piken 4.5 Autoriteti Kontraktor ka bërë ndryshimet si me poshte vijon:

Ishte :

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: 20/12/2024 (d/m/v) ora 10:00

Vendi: app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

Behet:

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: 30 /12/2024 (d/m/v) ora 10:00

Vendi: app.gov.al.”.

II.5. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 19.12.2024, në mbështetje të nenit 75 pika 2 të ligjit nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe bazuar në kërkesën për sqarim të paraqitur në SPE datë 19.12.2024, ka modifikuar kriterin kualifikues të përcaktuara në pikën 2.8 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” Loti 1 “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%”, si më poshtë vijon:

“Të nderuar operatorë ekonomikë!

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të ligjit nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” bazuar në kërkesën për sqarim të paraqitur në SPE datë 19.12.2024 AK ju bën me dije se ka bërë modifikimin dhe Sqarimin e kriterëve kualifikues si më poshtë vijon :

Ishte:

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës nëse është prodhues duhet të paraqesë Leje Mjedisit të tipit A, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Nëse operatori ekonomik ofertues nuk është vetë prodhues i produkteve objekt prokurimi të Lotit, duhet të ketë Kontratë/a furnizimi me prodhues të cilët janë të pajisur me lejet mjedisore.

Për përmbushjen e këtij kriteri të paraqiten kontrata/t e furnizimit të vlefshme si edhe lejet mjedisore përkatëse sipas përcaktimit të bërë në kriterin 2.8 të DT.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77 të LPP si dhe konform përcaktimeve të bëra në ligjin nr 10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar.

Kërkesa për qënësinë e kësaj leje mjedisore kërkohet vetëm dhe vetëm për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se veprimtaria për prodhimin e kimikateve bëhet në përputhje me rregullat mjedisore si dhe duke patur një qasje pozitive edhe miqësore kundrejt natyrës dhe mjedisit në tërësi. Në stabilimentet e prodhimit të kimikateve kryhen procese pune të cilat shkaktjnë dhe gjenerojnë mbetje të cilat mund të shkaktjnë ndotje në ujë dhe tokë, duke krijuar ndikim për biodiversitetin dhe shëndetin e popullsisë.

Pajisja me leje mjedisi siguron që veprimtaritë e përcaktuara të jenë në përputhje me masat e mbrojtjes së mjedisit. Parandalimii ndotjeve dhe mbetjeve të rrezikshme siguron një mjedis më të sigurt për popullsinë. Së fundmi LPP dhe RRPP me ndryshimet që kanë pësuar kanë sjellë në vëmendje dispozita të cilat lidhen dhe të orientojnë drejt prokurimit të gjelbër. Theksojmë se VKM nr 498 datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, sipas të cilit u ndryshua edhe neni 25 “Kriteret e Kualifikimit” parashikon se Autoritetet Kontraktore janë të detyruara që në hartimin e kriterëve të veçanta dhe specifikimeve të zbatojnë legjislacionin mjedisor, social e të punës – në mënyrë që të të ulet ndikimi negativ në mjedis. Pra përfshirja e kriterëve të gjelbra impakton në atë që promovohet gjithnjë e më shumë dhe që quhet “Prokurimi i qëndrueshëm”, pra një proces ku Autoritetet Kontraktore përmbushin nevojat e tyre për mallra, shërbime ose pune në një mënyrë duke impaktuar në minimizimin e dëmimit të mjedisit.

Bëhet:

2.8. Në rast se operatori ekonomik është importues atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST, si dhe kontratë furnizimi me furnitorin e huaj (distributor ose prodhues).

Operatori ekonomik pjesëmarrës nëse është prodhues vendas duhet të paraqesë **Leje Mjedisit të tipit A**, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas atëherë operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratë furnizimi me një prodhues vendas ose kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave kur mallrat vijnë nga jashte vendit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77 të LPP si dhe konform përcaktimeve të bëra në ligjin nr 10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar. Kërkesa për qënësinë e kësaj leje mjedisore kërkohet vetëm dhe vetëm për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se veprimtaria për prodhimin e kimikateve bëhet në përputhje me rregullat mjedisore si dhe duke patur një qasje pozitive edhe miqësore kundrejt natyrës dhe mjedisit në tërësi. Në stabilimentet e prodhimit të kimikateve kryhen procese pune të cilat shkaktjnë dhe gjenerojnë mbetje të cilat mund të shkaktjnë ndotje në ujë dhe tokë, duke krijuar ndikim për biodiversitetin dhe shëndetin e popullsisë.

Pajisja me leje mjedisi siguron që veprimtaritë e përcaktuara të jenë në përputhje me masat e mbrojtjes së mjedisit. Parandalimii ndotjeve dhe

mbetjeve të rrezikshme siguron një mjedis më të sigurt për popullsinë. Së fundmi LPP dhe RRPP me ndryshimet që kanë pësuar kanë sjellë në vëmendje dispozita të cilat lidhen dhe të orientojnë drejt prokurimit të gjelbër. Theksojmë se VKM nr 498 datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, sipas të cilit u ndryshua edhe neni 25 “Kriteret e Kualifikimit” parashikon se Autoritetet Kontraktore janë të detyruara që në hartimin e kriterëve të veçanta dhe specifikimeve të zbatojnë legjislacionin mjedisor, social e të punës – në mënyrë që të të ulet ndikimi negativ në mjedis. Pra përfshirja e kriterëve të gjelbra impakton në atë që promovohet gjithnjë e më shumë dhe që quhet “Prokurimi i qëndrueshëm”, pra një proces ku Autoritetet Kontraktore përmbushin nevojat e tyre për mallra, shërbime ose pune në një mënyrë duke impaktuar në minimizimin e dëmtimit të mjedisit.

Ne piken 4.5 Autoriteti Kontraktor ka bërë ndryshimet si me poshte vijon:

Ishte :

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: 30.12.2024 (d/m/v) ora 10:00

Vendi: app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, ëëë app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

Behet:

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: 09.01.2025 (d/m/v) ora 10:00

Vendi: app.gov.al.”.

II.6. Në datën 09.01.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.7. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 14.02.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Albania Distribution Chemicals” SHPK	0 lekë	skualifikuar
2. “CHIMICA-AL” SHPK	47.250.000 lekë	skualifikuar
3. “2 AT” SHPK	49.700.000 lekë	kualifikuar

II.8. Në datën 14.02.2025, operatori ekonomik “CHIMICA-AL” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Së pari Autoriteti kontraktin në kriteret e vecanta të kualifikimit përkatësisht në pikën 2.2.1 ka kërkuar si me poshtë vijon: 2.2.1. Vërtetimi për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik pjesëmarrës CHIMICAL –AL-SH,P,K ka paraqitur vërtetimin me nr T11784221 datë 04.11.2025 të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithme e Tatimeve mbi xhiron vjetore. Gjithashtu operatori ekonomik pjesëmarrës ka paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve publike vërtetim të lëshuar po nga Drejtoria e Përgjithme e Tatimeve (Drejtoria Rajonale e Tatimeve) përkatësisht vërtetimin me Nr .24333 Prot., datë 13.12.2024 për periudhën Janar – Neëntor 2024 duke pretenduar permushjen e kriterit të lart përmendur. Komisioni i vlerësimit të 3 ofertave ju bën me dije se vlera vërtetimit me nr T11784221 datë 04.11.2025 mbi përmbushje e xhiros vjetore është 56.125.618 leke duke mos përmbushur kriterin 2.2.1 të Kriterëve të vecanta të kualifikimit si dhe vërtetimi me Nr. 24333 Prot., datë 13.12.2024 është i pavlefshëm pasi Autoriteti kontraktor Ujësjiellës kanalizime Tirane ka kërkuar vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), dhe jo vitin 2024 . Komisioni i vlerësimit të ofertave bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 1.3.4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar si dhe referuar kthimit të përgjigjes së Agjencisë së Prokurimit publik me nr 774/1 prot datë 29.01.2025 i cili na vë në dijeni se Autoriteti Kontraktor duhet ti referohet kërkesave konkrete të përcaktuara në dokumentat Standarte të tenderit sa i takon kapaciteteve ekonomike dhe financiare si dhe dokumentave të paraqitura nga ofertuesi ,operatori ekonomik pjesëmarrës nuk e plotëson kriterin e sipërcituar. Së dyti, Autoriteti kontraktin në kriteret e vecanta të kualifikimit përkatësisht në pikën 2.2.2 ka kërkuar si me poshtë vijon: 2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021,2022,2023) të çertifikuara nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Nëse kërkojnë bilancet të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik të prokurimeve konstaton se operatori ekonomik ka paraqitur për permushjen e këtij kriteri vetëm pasqyrat financiare për vitin 2023 duke rënë në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit përkatësisht pikën 2.2.2 të Dokumentave Standarte të Tenderit. Bazuar në VKM-në 285 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (I ndryshuar), referuar Nenit 43, Kërkesat për kapacitetet ekonomike- financiare, pika 4, lejon Autoritetin Kontraktor të kërkojë bilancet e tre viteve për të bërë verifikimet e nevojshme në plotësimin e kapaciteteve të kërkuara nga AK. Komisioni i vlerësimit të ofertave bazuar në bazën ligjore të sipërcituar, gjithashtu në kriterin 2.2.2 si dhe referuar kthimit të përgjigjes së Agjencisë së Prokurimit publik me nr 774/1 prot datë 29.01.2025 hyrë në Ukt sh.a me shkresën me nr K-261 prot ,datë 31.01.2025 i cili na vë në dijeni se Autoriteti Kontraktor duhet ti referohet kërkesave konkrete të përcaktuara në dokumentat Standarte të tenderit sa i takon kapaciteteve ekonomike dhe financiare si dhe dokumentave të paraqitura nga ofertuesi. Në DST parashikohet shprehimisht Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. Subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST. Vendosja e kriterëve të

kualifikimit kane si synim ti sherbejne AK per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomik ,te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne zoterojne kualifikimet e nevojse teknike,profesionale, kapacitetin 4 ekonomike,financiare dhe organizative ,makinerite,paisjet e asete te tjera fizike ,reputacionin dhe besueshmerine,pervojen e duhur si dhe personelin e nevojshem,gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates.Ne varesi te volumit te saj AK percakton kerkesat per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per tu permbushur nga opertoret ekonomik pjesmarres ne procedurat e prokurimit. Komisioni I vleresimit te ofertave sqaron se eshte detyrim ligjor I subjektit ofertues te provoje me dokumentacion te plote dhe ne perputhje me kerkesat e AK plotesimin e kriterëve te kerkuara ne dokumentat standarte te tenderit ,pasi ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta do te refuzohen sit e pa pranueshme Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, neni 92/3të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar Neni 79, neni 80, neni 82 e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”.

II.9. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 19.02.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë “2 AT” SHPK.

II.10. Në datën 26.02.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 549/2025, datë 26.02.2025 dhe numër elektronik A/2025/5083, datë 26.02.2025, e operatorit ekonomik “CHIMICA-AL” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 549/1 prot, datë 27.02.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “CHIMICA-AL” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “2 AT” SHPK ka paraqitur argumente, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 549/2 prot., datë 28.02.2025.

II.13. Me shkresën nr. 17735/22 prot, datë 07.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 549/3 prot datë 10.03.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe informacioni për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “CHIMICA-AL” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk i ka pranuar pretendimet e ngritura

nga ankimuesi në ankesë lidhur me kundërshtimin arsyeve të skualifikimit, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “CHIMICA-AL” ShPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se: “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “CHIMICA-AL” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij se: “Së pari Autoriteti kontraktori në kriteret e vecanta të kualifikimit përkatësisht në piken 2.2.1 ka kërkuar si me poshtë vijon: 2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit të lotit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik pjesëmarrës CHIMICA –AL-SH,P,K ka paraqitur vërtetimin me nr T11784221 datë 04.11.2025 të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithme e Tatimeve mbi xhiron vjetore. Gjithashtu operatori ekonomik pjesëmarrës ka paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve publike vërtetim të lëshuar po nga Drejtoria e Përgjithme e Tatimeve (Drejtoria Rajonale e Tatimeve) përkatësisht vërtetimin me Nr .24333 Prot., datë 13.12.2024 për periudhën Janar – Neëntor 2024 duke pretenduar permushjen e kriterit të lart përmendur. Komisioni i vlerësimit të 3 ofertave ju bën me dije se vlera e vërtetimit me nr T11784221 datë 04.11.2025 mbi përmbushjen e xhiros vjetore është 56.125.618 leke duke mos përmbushur kriterin 2.2.1 të Kriterëve të vecanta të kualifikimit si dhe vërtetimi me Nr. 24333 Prot., datë 13.12.2024 është i pa vlefshëm pasi Autoriteti kontraktor Ujësjellës kanalizime Tirane ka kërkuar vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), dhe jo vitin 2024 . Komisioni i vlerësimit të ofertave bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 1.3.4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e

ndryshuar si dhe referuar kthimit të përgjigjes së Agjencisë së Prokurimit public me nr 774/1 prot datë 29.01.2025 I cili na vë në dijeni se Autoriteti Kontraktor duhet ti referohet kërkesave konkrete të përcaktuara në dokumentat Standarte të tenderit sa I takon kapaciteteve ekonomike dhe financiare si dhe dokumentave të paraqitura nga ofertuesi ,operatori ekonomik pjesmarrës nuk e ploteson kriterin e sipercituar.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 17.12.2024, në mbështetje të nenit 75 pika 2 të ligjit nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe bazuar në monitorimin e Agjencisë së Prokurimit Publik datë 16.12.2024, ka modifikuar kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pikën 2.3.1 “Aftësitë teknike dhe profesionale” dhe pikën 2.8 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” Loti 1 “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%”, si më poshtë vijon:

“Të nderuar operatorë ekonomikë!

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të ligjit nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” bazuar monitorimin e App date 16.12.2024 AK ju bën me dije se ka bërë modifikimin dhe Sqarimin e kriterëve kualifikues si më poshtë vijon :

Ishte:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Nëse operatori ekonomik oferton për lote të veçanta, vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës të kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit përkatës , ose shumës se loteve që oferton).

Bëhet:

2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/a e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i

viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit të lotit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Ishte:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël 30.100.000 (tridhjetë milion e njëqind mijë) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara,

ose,

d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara.

Bëhet:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se **40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- c. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat **dhe sasi të mallrave të furnizuara**.

- d. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat **dhe sasitë e mallrave të furnizuara**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Ishte:

2.8. Në rast se operatori ekonomik është importues atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojet e sasitë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL për të gjitha kimikatet e kërkuara nga AK.

Në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas atëherë operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratë furnizimi me një prodhues vendas shoqëruar me lejen mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL të prodhuesit vendas ose kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojet e sasitë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Bëhet:

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës nëse është prodhues duhet të paraqesë **Leje Mjedisi të tipit A**, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Nëse operatori ekonomik ofertues nuk është vetë prodhues i produkteve objekt prokurimi të Lotit , duhet të ketë **Kontratë/a furnizimi me prodhues të cilët janë** të pajisur me lejet mjedisore.

Për përmbushjen e këtij kriteri të paraqiten kontrata/t e furnizimit të vlefshme si edhe lejet mjedisore përkatëse sipas përcaktimit të bërë në kriterin 2.8 të DT.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77 të LPP si dhe konform përcaktimeve të bëra në ligjin nr 10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar.

Kërkesa për qënësini e kësaj leje mjedisore kërkohet vetëm dhe vetëm për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se veprimtaria për prodhimin e kimikateve bëhet në përputhje me rregullat mjedisore si dhe duke patur një qasje pozitive edhe miqësore kundrejt natyrës dhe mjedisit në tërësi.

Në stabilimentet e prodhimit të kimikateve kryhen procese pune të cilat shkaktojnë dhe gjenerojnë mbetje të cilat mund të shkaktojnë ndotje në ujë dhe tokë, duke krijuar ndikim për biodiversitetin dhe shëndetin e popullsisë.

Pajisja me leje mjedisi siguron që veprimtaritë e përcaktuara të jenë në përputhje me masat e mbrojtjes së mjedisit. Parandalimi i ndotjeve dhembetjeve të rrezikshme siguron një mjedis më të sigurt për popullsinë. Së fundmi LPP dhe RRPP me ndryshimet që kanë pësuar kanë sjellë në vëmendje dispozita të cilat lidhen dhe të orientojnë drejt prokurimit të gjelbër. Theksojmë se VKM nr 498 datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, sipas të cilit u ndryshua edhe neni 25 “Kriteret e Kualifikimit” parashikon se Autoritetet Kontraktore janë të detyruara që në hartimin e kriterëve të veçanta dhe specifikimeve të zbatojnë legjislacionin mjedisor, social e të punës – në mënyrë që të të ulet ndikimi negativ në mjedis. Pra përfshirja e kriterëve të gjelbra impakton në atë që promovohet gjithnjë e më shumë dhe që quhet “Prokurimi i qëndrueshëm”, pra një proces ku Autoritetet Kontraktore përmbushin nevojat e tyre për mallra, shërbime ose pune në një mënyrë duke impaktuar në minimizimin e dëmtimit të mjedisit.

Ne piken 4.5 Autoriteti Kontraktor ka bërë ndryshimet si me poshte vijon:

Ishte :

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: 20/12/2024 (d/m/v) ora 10:00

Vendi: app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

Behet:

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: 30 /12/2024 (d/m/v) ora 10:00

Vendi: app.gov.al.”.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 3, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohe nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohe operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”.

III.1.5. Në nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave” pikat 3, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.6. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tri) vitet e fundit financiare.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. [...].

Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.”.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe hartimi i dokumenteve të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në datë 18.11.2024 ka përcaktuar në pikën 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” Loti 1 “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë: “2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare

konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Nëse operatori ekonomik oferton për lote të veçanta, vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës të kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit përkatës**, ose shumës se loteve që oferton”, ndërkohë që në datën 17.12.2024 e modifikon këtë kriter kualifikues, duke përcaktuar si në vijim: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.”, ndërsa në nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”. Ndërkohë në nenin 43 pikat 2 “Kërkesat për kapacitet ekonomik financiar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Nga sa më sipër KPP, vëren, se në tërësi kriteri i përcaktuar në pikën 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” Loti 1 “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi është modifikuar duke rënduar pozitën e operatorëve ekonomike ofertues, pasi në datën 18.11.2024 autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të kenë realizuar një xhiro në vlerën jo më të vogël se 40% e fondit limit të lotit, ndërsa me modifikimin e këtij kriteri në datën 17.12.2024 ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të kenë realizuar një xhiro në vlerën jo më të vogël se vlera e fondit limit të lotit, duke rritur vlerën e kërkuar për kualifikim me rreth 45.150.000 (dyzet e pesë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) leke dhe për më tepër pa argumentuar rritjen e kësaj vlere, çka është diskriminues dhe në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore konkretisht me nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë

19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin e barazisë në trajtimin e operatorëve ekonomike dhe duke mos u ngarkuar atyre të njëjtat të drejta dhe detyrime. Konkretisht me modifikimin e këtij kriteri kualifikues, KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka rënduar pozitën e operatorëve ekonomikë ofertues, pasi rritja e vlerës së xhiros së kërkuar nuk është e argumentuar, duke rënë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore të mësipërcituara, Ligjvënësi ka theksuar se në çdo rast, në kërkesën për vlerën e xhiros së 3 (tre) viteve të fundit duhet që autoriteti kontraktor jo vetëm të mos tejkalojë kërkesën për vlerën deri në dyfish të vlerës së fondit limit të lotit (në procedurat e prokurimit mbi kofirin e lartë monetar), por njëkohësisht ka dhe detyrimin për të argumentuar përcaktimin e vlerës së xhiros së kërkuar brenda këtij diapazoni.

KPP gjykon, se modifikimi i kriterit të përcaktuar në pikën 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” Loti 1 “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi në mënyrën e formularit është në kundërshtim me parashikimet e nenit 43, pika 2 të VKM së sipërcituar, pasi rritja e vlerës së xhiros së kërkuar është e paargumentuar dhe ka rënduar pozitën e **operatorit ekonomik ankimes, duke shkaktuar** konfuzion në radhët e operatorëve ekonomikë dhe njëherazi në punën e KVO-së gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pasi nuk përputhet me qëllimin dhe frymën e dispozitës ligjore. Dispozita ligjore ka për qëllim të ndalojë autoritetet kontraktore të kërkojnë vlerë të xhiros së realizuar në vlerën mbi dyfishin e vlerës fondit limit të lotit (në procedurat e prokurimit mbi kofirin e lartë monetar) dhe njëkohësisht detyrimin e autoritetit kontraktor për të argumentuar vlerën e xhiros së kërkuar brenda këtij diapazoni, duke gjykuar, se përcaktimi i një vlere xhiroje të argumentuar brenda këtij diapazoni është e mjaftueshme për të dëshmuar përmbushjen e kapacitetit ekonomik financiar të operatorit ekonomik, por nuk ka për qëllim të rëndojë pozitën e operatorëve ekonomikë ofertues duke e rritur vlerën e xhiros së kërkuar pas modifikimit të këtij kriteri kualifikues. KPP gjykon, se me këtë kriter autoriteti kontraktor vjen në kundërshtim me frymën e ligjvënësit dhe me parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin 77 të ligjit dhe në nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke diskriminuar operatorët ekonomikë, duke shkelur parimin e mosdiskriminimit dhe barazisë së kandidatëve dhe parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe duke mos u ngarkuar operatorëve të njëjtat të drejta dhe detyrime.

Në këto kushte, KPP vëren parregullsi dhe paligjshmëri në lidhje me përcaktimin e kriterit mbi paraqitjen e vërtetit për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit**. Lidhur me këtë konstatim KPP gjykon, se kriteret kualifikuese të procedurës së prokurimit duhet të përcaktohen, të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Mosargumentimi i rritjes së vlerës së xhiros së kërkuar si në rastin konkret, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit. Në këto kushte KPP gjykon, se modifikimi në këtë rast për shkak të të metave të rëndësishme si ato të kriterëve në kundërshtim me frymën e ligjit dhe akteve nënligjore në hartimin e dokumenteve të

procedurës së prokurimit, përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.8. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikime thelbësore në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi duhet të rishikojë kriterin ekonomiko-financiar në lidhje me bilancet në përputhje me parashikimet ligjore të nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenin 43 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.1.9. Në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin”, nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji përcaktohet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.”. Në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se procesi i hartimit dhe përcaktimit të dokumenteve standarde të tenderit konkretisht të xhiros, është bërë jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik për shkaqet e sipërcituara, ndaj përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentet e tenderit janë haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj, përbën shkak për anulimin e tyre. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi, duke hartuar, kriteret për kualifikim, në përputhje me nevojat reale dhe përcaktimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik. Në kushtet kur autoriteti kontraktues ka vlerësuar mbi kriteret që bien në kundërshtim me frymën e ligjit të prokurimit publik, mbi të cilat ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë, Komisioni i

Prokurimit Publik gjykon, se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim, pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “CHIMICA-AL” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së kualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, si në vijim: “Së dyti, Autoriteti kontraktin në kriteret e vecanta të kualifikimit përkatësisht në pikën 2.2.2 ka kërkuar si me poshtë vijon: 2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021,2022,2023) të çertifikuara nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Nëse kërkohen bilancet të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik të prokurimeve konstaton se operatori ekonomik ka paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri vetëm pasqyrat financiare për vitin 2023 duke rënë në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit përkatësisht pikën 2.2.2 të Dokumentave Standarte të Tenderit. Bazuar në VKM-në 285 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (I ndryshuar), referuar Neni 43, Kërkesat për kapacitetet ekonomike-financiare, pika 4, lejon Autoritetin Kontraktor të kërkojë bilancet e tre viteve për të bërë verifikimet e nevojshme në plotësimin e kapaciteteve të kërkuara nga AK. Komisioni i vlerësimit të ofertave bazuar në bazën ligjore të sipërcituar, gjithashtu në kriterin 2.2.2 si dhe referuar kthimit të përgjigjes së Agjencisë së Prokurimit publik me nr 774/1 prot datë 29.01.2025 hyrë në Ukt sh.a me shkresën me nr K-261 prot ,datë 31.01.2025 i cili na vë në dijeni se Autoriteti Kontraktor duhet ti referohet kërkesave konkrete të përcaktuara në dokumentat Standarte të tenderit sa I takon kapaciteteve ekonomike dhe financiare si dhe dokumentave të paraqitura nga ofertuesi. Në DST parashikohet shprehimisht Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. Subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST. Vendosija e kriterëve të kualifikimit kanë si synim të shërbejnë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomik ,te cilët nepermjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vertetohen zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike,profesionale, kapacitetin 4 ekonomike,financiare dhe organizative ,makinerite,paisjet e asete të tjera fizike ,reputacionin dhe besueshmerine,pervojen e duhur si dhe personelin e nevojshem,gjithcka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.Ne varesi të volumit të saj AK përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për të përmbushur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i vlerësimit të ofertave sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e AK plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit ,pasi ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumenta do të refuzohen sipas parashikimeve Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, neni 92/3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar Neni 79, neni 80, neni 82 e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk

plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” Loti 1 “*Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%*” pika 2.2.2 “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*” të dokumentave të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

“2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (**2021, 2022, 2023**) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”.

III.2.2. Për përmbushjen e kriterëve kualifikues të përcaktuara në pikën 2.2.2 “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*” të shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” Loti 1 “*Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%*” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, rezultojnë se nga verifikimi i dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik ofertues “*CHIMICA-AL*” SHPK në sistemin elektronik të prokurimit (SPE) për përmbushjen e këtij kriteri kualifikues ka dorëzuar përkatësisht dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- Shkresën “*Kthim përgjigje*” nr. 20708 prot, datë 15.10.2024, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, ku citohet si më poshtë vijon:
“Në përgjigje të kërkesës tuaj me numër çështje E0001317965 datë 09.10.2024, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor, për vitet:
• Viti 2023 të dorëzuara elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë format i ndryshuar më datë 30.07.2024.”, bashkëlidhur dokumenti “*PASQYRAT FINANCIARE, VITI 2023*”.
- Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregëtar datë 11.12.2024, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me nënshkrim elektronik, me anë të së cilës provohet se subjekti “*CHIMICA-AL*” SHPK është themeluar në datën 03/05/2023.

III.2.3. Lidhur me pretendimet e parashtruara nga ana e operatorit ekonomik ankimues “*CHIMICA-AL*” SHPK në ankesën me numër ankimi elektronik A/2025/5083, datë 26.02.2025 dhe numër protokolli nr. 549/2025, datë 26.02.2025, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor me shkresën nr. 17735/22 prot, datë 07.03.2025, ka argumentuar si në vijim: “... Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik të prokurimeve konstaton se operatori ekonomik ka paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri vetëm pasqyrat financiare për vitin 2023 duke rënë në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit përkatësisht pikën 2.2.2 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Bazuar në VKM-në 285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), referuar Nenit 43, Kërkesat për kapacitetet ekonomike- financiare, pika 4, lejon Autoritetin Kontraktor të kërkojë bilancet e tre viteve për të bërë verifikimet e nevojshme në plotësimin e kapaciteteve të kërkuara nga AK.

Komisioni i vlerësimit të ofertave bazuar në bazën ligjore të sipërcituar, gjithashtu në kriterin 2.2.2 si dhe referuar kthimit të përgjigjes së Agjencisë së Prokurimit Publik me nr 774/1 prot datë 29.01.2025 hyrë në Ukt sh.a me shkresën me nr K-261 prot ,datë 31.01.2025 i cili na vë në dijeni se Autoriteti Kontraktor duhet ti referohet kërkesave konkrete të përcaktuara në dokumentat Standarte të tenderit sa I takon kapaciteteve ekonomike dhe financiare si dhe dokumentave të paraqitura nga ofertuesi.

Operatori ekonomik anëtmues pretendon ndryshimin e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe kualifikimin e ofertës së firmës “ CHIMICA —AL sh.p.k.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave;

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik, proceverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe dokumentat standarte të tenderit, si dhe pretendimet e prarashtruara në ankesë në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij konstaton se:

Për ofertuesin "CHIMICA-AL" sh.p.k Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar dhe dhënë automatikisht nëpërmjet sistemin elektronik më datë 17.02.2025 arsyet e skualifikimit të ofertës së tij, duke mos plotësuar pikën 2.2.1. dhe 2.2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit të dokumentave standarte të tenderit përkatësisht xhiron vjetore për vitet (2021-2022-2023) dhe pasqyrat financiare (2021- 2022 - 2023) .

Sa më sipër cituar Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ju bën me dije se nëse operatori ekonomik do të kishte pas pretendime në lidhje me kërkesat e vendosura në Dokumentat Standarte të Tenderit nga autoriteti kontraktor në lidhje me xhiron vjetore të tre viteve të fundit (2021-2022-2023) si dhe pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) e ka patur në dizpozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me prendimet e tij bazuar kjo në nenin 110 pika 1 në të cilën citohet " 1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Përsa më sipër, vlerësojmë se ankesa e operatorit ekonomik nuk qëndron dhe si rrjedhojë nuk pranohet.”, duke mos pranuar pretendimet e ankimuesit.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 3, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohe nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohe operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër..”.

III.2.6. Në nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave” pikat 3, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.7. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vjetët e fundit financiarë, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit...”

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.9. Nga shqyrtimi i kriterëve kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor për tu siguruar se operatorët ekonomikë ofertues kanë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të realizuar furnizimin me produktin

“Hipoklorit Natriumi 13-15%” sipas një standardi të përshtatshëm cilësie ka përcaktuar kriterin kualifikues në pikën 2.2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” Loti 1 “*Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%*” të dokumentave të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues në fazën e ofertimit me qëllim kualifikimi, duhet të paraqesin pasqyrat financiare vjetore (bilancet) e 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të çertifikuara nga organet tatimore.

III.2.10. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “*CHIMICA-AL*” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, Komisioni konstaton se në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues “*CHIMICA-AL*” SHPK për të vërtetuar kapacitetin ekonomik dhe financiar ka dorëzuar pasqyrën financiare të vitit 2023, për plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor parashikuar në pikën 2.2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit si më sipër cituar. Referuar ekstraktit të regjistrit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit rezulton, se operatori ekonomik “*CHIMICA-AL*” SHPK është regjistruar si shoqëri tregtare në datën 03.05.2023 dhe dokumentacioni që ka paraqitur i përket respektivisht vitit 2023. Në këto kushte, mungesa e pasqyrave financiare për vitet 2021 dhe 2022 nuk mund të konsiderohet shkak për skualifikimin e këtij operatori ekonomik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*CHIMICA-AL*” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”,”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “*CHIMICA-AL*” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-29714-11-15-2024 me objekt: “*Blerje Kimikate për UKT sh.a e ndarë në lote*”, me fond limit të përgjithshëm 198.275.000 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) leke pa tvsh ose 2.019.505 (dy milion e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesë) euro pa tvsh, Loti 1, me numër reference: REF-29716-11-15-2024, me objekt: “*Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%*”, me fond limit të lotit 75.250.000 (shtatëdhjetë e pesë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh ose 735.893,3 (shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre presje tre) euro pa tvsh, zhvilluar me datë 09.01.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë SH.A.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 3. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik *CHIMICA-AL* ShPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

